



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.04.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 21, 25, 26 dhe 27 mars 2019.

2. Shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Edlira Bode

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, Sektori i Studimeve, Monitorimit të Akteve dhe Inspektimit

Gerti Loli - Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, Sektori i Përgjimit

Jon Smibert - këshilltar ligjor rezident në Departamentin e Drejtësisë në Ambasadën Amerikane

Brunilda Jani - Këshilltare në Ambasadën Amerikane

Idlir Peçi - Ekspert ndërkombëtar i EURALIUS-it

Fabian Zhilla - Ekspert i lartë vendas

Ardit Hysa - Këshilltar i Ministrit të Mbrojtjes

Sokol Gugashi - Oficer i Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake Julian Hodaj –
Zëvendësministër i Brendshëm

Alma Emini- Shefe Sektori ne Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Brian Thiessen – Përfaqësues i OSBE-së

Brunilda Halili– Përfaqësuese e OSBE-së

Edis Ibrahimimi - Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi - Përgjegjëse Sektori i Reformave Ligjore dhe Përafrimit të
Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Klodian Haxhillari - Drejtor i SHKBB-së

Fiona Kuqi- Specialiste ne Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, Sektori Tatimor në
Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, meqenëse plotësohet kuorumi.

Sot në rendin e ditës kemi: së pari, miratimin e procesverbaleve të komisionit të datave 21, 25, 26 dhe 27 mars të vitit 2019.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet.

Së dyti, shqyrtimin dhe miratimin nën për nën të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator i këtij projektligji është deputeti Alket Hyseni dhe deputetja Elena Xhina.

Para se të fillojmë me shqyrtimin nën për nën të këtij projektligji, dua t’u bëj me dije kolegëve se Komisioni i Sigurisë, si komision për dhënie mendimi, është në shqyrtim të këtij projektligji dhe ende nuk e ka përfunduar plotësisht. E thashë këtë, pasi sot ne do të vazhdojmë shqyrtimin nën për nën të këtij projektligji, por nuk do ta mbyllim me votimin në tërësi.

Ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe i përket paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi, së bashku me ligjin “Për shërbimin përmbartësor privat në Republikën Shqipërisë”, që është në diskutim e sipër në komision, si dhe me projektvendimin “Për strategjinë e edukimit ligjor”. Pas votimit në Kuvend mbyllet plotësisht paketa e dytë e projektligjeve të reformës në drejtësi. Ka një interes të shtuar për këtë projektligj nga të gjitha agjencitë, që punojnë me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Prokuroria e Përgjithshme, zoti Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, sektori i Studimeve, Monitorimit të Akteve dhe Inspektimit, si dhe oficeri i Policisë Gjyqësore, zoti Gerti Loli. Nga Departamenti i Drejtësisë në ambasadën amerikane kemi të ftuar zotin Jon Smibert, këshilltar ligjor. Zoti Smibert ka qenë me ne që në momentet e para të fillimit të reformës në, duke dhënë kontributin e tij të çmuar në të gjitha projektligjet, që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë penale. Po ashtu, nga ambasada amerikane kemi të ftuar zonjën Brunilda Jani, këshilltare. Nga misioni EURALIUS kemi të ftuar zotin Ildir Peçi, ekspert ndërkombëtar dhe zotin Fabian Zhilla, ekspert i lartë vendas, të cilët kanë punuar në grupin e punës për draftimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Nga Ministria e Mbrojtjes kemi të ftuar zotin Ardit Hysa, këshilltar, dhe majorin, zotin Sokol Gugashi, oficer i Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake. Nga Ministria e Brendshme kemi të ftuar zëvendësministrin, zotin Julian Hodaj, i cili ka qenë pjesëmarrës që në fillim në diskutimin e këtij projektligji. Po ashtu, e ftuar është

edhe zonja Alma Emini, shefe Sektori ne Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Brendshme. Nga prezenca e OSBE-së në Tiranë kemi të ftuar dy përfaqësues, zotin Brian Thiessen dhe zonjën Brunilda Halili. Nga Ministria e Brendshme kemi të ftuar zotin Edis Ibrahim, këshilltar, dhe zonjën Eljona Bylykbashi, përgjegjëse e Sektorit të Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit. Nga SHKBB-ja kemi të ftuar zotin Klodian Haxhillari. Së fundi, nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve kemi të ftuar zonjën Fiona Kuqi.

Në fakt, pjesëmarrja e gjithë këtyre aktorëve dhe faktorëve në shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji flet për rëndësinë që ka ky projektligj, si dhe vëmendjen e shtuar të komisionit për miratimin e tij.

Unë do t'u kërkoja relatorëve, zotit Hyseni dhe zonjës Xhina, që ta ndjekin në dinamikë kalimin e secilit prej neneve të këtij projektligji. Po ashtu, do të kërkoja nga të gjithë përfaqësuesit që i kemi të pranishëm sot në komision që të ndërhyjnë në ato nene, ku kanë për të dhënë sugjerimet apo mendimet e tyre,. Gjithashtu, për efikasitetin e punës së këtij komisioni, aty ku mund të kemi probleme me nene të caktuara, mund t'i lemë të hapura, në mënyrë që në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, para votimit në tërësi, të mund t'i kalojmë edhe ato nene, të cilat mund të ngelen të hapura në punë e sipër.

A kanë ndonjë gjë për të shtuar relatorët para se të fillojmë me shqyrtimin nen për nen?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju bëtë një ekspozë të gjerë, por ajo që unë dhe kolegja Xhina duam të shtojmë është fakti se ka qenë një grup pune shumë i madh, i cili ka kontribuar për këtë draft që kemi sot. Ne duam t'i falënderojmë, duke filluar në mënyrë të veçantë me zotin Ligor, zotin Beluri dhe më pas zotin Luli, nga Prokuroria e Përgjithshme; zotin Peçi dhe zotin Zhilla, ekspertë të EURALIUS-it; nga OPGJ-ja ka qenë zoti Loli; nga ministria e Drejtësisë ka qenë zonja Treska, si dhe këshilltaren tonë të Kuvendit! Unë së bashku me kolegen Xhina kemi bërë një numër rekord mbledhjesh për sa i takon këtij projektligji dhe kemi pasur diskutime të shumta dhe mendime të ndryshme në shumë aspekte, por ia kemi dalë që të paraqesim një draft pothuajse konsensual, sepse aktorët që kanë marrë pjesë nuk kanë qenë plotësisht dakord me elemente të caktuara, por jemi përpjekur të marrim më të mirën e mundshme nga gjithsecili prej tyre.

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj misionin e OPDAT-it, i cili ka bërë rekomandimet në mbledhjet që kemi bërë dhe ne jemi përpjekur që t'i pasqyrojmë maksimalisht në draftin tonë.

Këtij ligji i kemi kushtuar shumë rëndësi, jo vetëm se është një nga ligjet përmbyllëse të paketës së reformës në drejtësi, por edhe sepse është një hallkë e rëndësishme e suksesit të hetimit penal. Ky ligj jo vetëm që do të jetë më i mirë se ligji në fuqi, por do të ketë siguri dhe garanci për një hetim rezultativ. Pra, puna e madhe e strukturave të policisë do të përcillet proceduralisht ashtu siç duhet në organet e prokurorisë dhe gjykatës, për mundësuar rezultatin maksimal të saj.

Falënderoj kolegën Xhina, e cila ka pasur durim të madh dhe ka punuar më shumë se të tjerët.

Falënderoj edhe kryetarin për të gjithë mbështetjen që na ka dhënë për këtë proces.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Në tryezën e punës kolegët dhe të ftuarit kanë draftin e integruar të projektligjit. Në formë tabele kemi projektligjin e depozituar në Kuvend sipas variantit të depozituar nga nismëtari në Kuvend dhe në krahun e djathtë të tabelës është projektligji që propozohet për shqyrtim pas ripunimit nga grupi i punës.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit. Ju lutem, të shprehni mendimet për secilin nga nenet

Nen 1, përcakton objektin e ligjit

Fjalën e ka zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Për nenin 1 kemi një riformulim, nga varianti i parë i ardhur në komision, i cili detajon pak më shumë parimet dhe rregullat që referohen në këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka komente për nenin 1? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 1. Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit të grupit të punës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2, “Përkufizimet”.

Elena Xhina – Në këtë nen ka ndryshuar titullit i tij, por ka edhe riformulime në disa pika konkrete, siç është riformulimi i pikës 2, ku është marrë parasysh sugjerimi i Ministrisë së Mbrojtjes për të shtuar togfjalëshin “Policia Ushtarake”.

Kemi riformulim të pikës 6, në referencë të Ministrisë së Mbrojtjes, me përmbajtjen e nenit 18, ku kërkohet rakordimi i tij me ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Kemi riformulim të pikës 7, e cila është bërë në referencë të Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me termin që përdoret për emërtimin e prokurorive pranë gjykatave. Pra është terminologji.

Edhe në pikën 5 kemi ndryshimin e termit, i cili është bërë “papajtueshmëri etike”, duke pasur parasysh një vendim të Gjykatës Kushtetuese që ta pasqyrojmë në këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Fjalën e ka zoti Peçi.

Idlir Peçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të ngre një shqetësim, i cili po reflektohet në të gjithë projektligjin, për sa u përket agentëve. Vërejmë se në shumë nene të projektligjit agentët janë hequr, duke filluar me nenin 2, në përkufizimin për strukturën hetimore. Për këtë kemi edhe komente nga kolegët tanë të PAMECA-s, të cilat janë në të njëjtën linjë. Pra, ideja është që nëse hiqen agentët nga struktura hetimore, atëherë rrezikohet që, të mos e kemi informacionin operacional që mbledhin agentët, por të kemi vetëm atë të oficerëve. Pra, ndarja e shërbimit të Policisë Gjyqësore vetëm me oficerë dhe pa agentët rrezikon që të ketë një inefektivitet të hetimit. Gjatë punës me grupin e punës, ne kemi këmbëngulur që agentët të jenë në strukturë, në përkufizime, por edhe në nene të tjera vijuese. Pra, në përkufizim duhet të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë, por nuk janë në strukturë. Në strukturë thuhet: “Struktura hetimore është pjesë e përgjithshme e Policisë së Shtetit të përbërë nga oficerët.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, duhen shtuar edhe agentët në strukturën hetimore të Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ka pasur një diskutim të gjerë në lidhje me përfshirjen apo jo të agentëve të Policisë Gjyqësore në këtë ligj. Shumica e grupit të punës në gjykimin e tij ka qenë që ne duhet të bëjmë një ligj për aspektin procedural të hetimit, jo për tërësinë e veprimtarisë policore. Kjo gjen zgjidhje sot, por do të gjejë akoma më mirë në ligjin e ri të Policisë së Shtetit. Këtë bisedë e kemi pasur edhe me Ministrinë e Brendshme dhe për këtë arsye ne kemi gjykuar që subjekt të këtij ligji të mos jetë agjenti i policisë.

Për sa i takon sugjerimit, në pikën 6 mund ta vendosim agjentin në përkufizimin e strukturës, sepse në aspektin policor ai mund të përfshihet në procesin hetimor.

Ne kemi edhe një nen më poshtë në ligj, i cili për raste të veçanta jo vetëm agjenti i policisë, por edhe nënpunës të tjerë mund të bëjnë veprime të shpejta hetimore, sidomos në ruajtjen e provave, por duke vënë në dijeni menjëherë strukturat përkatëse hetimore.

Pra, pranojmë që në pikën 6 të futet “agjenti i policisë” në përkufizimin e strukturës hetimore, duke ruajtur logjikën që më vonë në ligj të mos jenë më subjekt i këtij ligji.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A keni ndonjë gjë në lidhje me nenin 2?

Kujtim Luli – Në lidhje me nenin 2, unë kam dy komente dhe sugjerime për ndryshime. Njëri është për pikën 5, ku shprehja “papajtueshmëria ambientale” është bërë “papajtueshmëria etike”, ku përfshihet edhe “gjendja familjare”. Nuk ka lidhje gjendja familjare me papajtueshmërinë etike dhe sugjeroj që të hiqet “gjendja familjare” për faktin se lidhjet për arsye familjare përbëjnë papajtueshmërinë sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin kur këto papajtueshmëri shkojnë te oficeri i Policisë Gjyqësore, referuar nenit 27, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, ashtu si prokurori mund të heqë dorë edhe oficeri i Policisë Gjyqësore ose mund të kërkohet largimi i tij nga çështja konkrete.

Sa i përket pikës 6, është togfjalëshi “oficerë të shërbimeve policore”, për të cilin sugjeroj të përqaset me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nenet 30,31,32 të këtij Kodi, duke e ndryshuar në “oficerë të shërbimeve të Policisë Gjyqësore”, ose nëse do të shtohet edhe fjala “agjentëve” në këtë pikë, siç u diskutua nga parafolësit, të bëhet “oficerëve dhe agjentëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore”. Është një terminologji që shkon në përjasje me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Luli!

Unë kam një pyetje për ekspertët për pikën 5, e cila flet për papajtueshmërinë etike. A ka mundësi që me një situatë konkrete të ma shpjegoni pse është vendosur në pikën 5 “papajtueshmëria etike”. Cili mund të ishte një rast i papajtueshmërisë etike për shkak të raporteve që burojnë nga gjendja familjare?

Alket Hyseni – Më lejoni t’u bëj me dije komisionit dhe të pranishmëve që ka pasur një koncept tjetër, ka qenë koncepti “papajtueshmëri ambientale”, në një nga ligjet e reformës, një nen i cili është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese. Çfarë nënkuptonte “papajtueshmëria ambientale”, që të dalim çfarë kemi synuar te “papajtueshmëria etike”. Janë shumë raste ku proceduralisht nga Kodi i Procedurës Penale nuk i detyrojnë të japin dorëheqjen ose të përjashtohen nga veprime të caktuara hetimore as oficeri i Policisë Gjyqësore, as prokurori, as gjykatësi. Pra, këto raste nuk i parashikon kodi procedural, por në vetvete kanë problematikë, për shembull, një nga familjarët jo të afërt, pra jo te rrethi ku përfshihet në Kodin e Procedurës

Penale, por jashtë këtij rrethi ka probleme penale në të kaluarën, kështu që ky mund të jetë një rast që e bën oficerin e Policisë Gjyqësore një person jo të denjë për atë hetim, po kështu është termi për “lidhje të papërshtatshme shoqërore”. Pra, Kodi i Procedurës Penale nuk e ka parashikuar si shkak për përjashtim, por mund të jetë një shkak i pastër i papajtueshmërisë etike marrëdhëniet me një person të papërshtatshëm, dhe aq më tepër që është e qartë çështja e konfliktit të interesit, që është rast i pastër konflikt interesi, ku një marrëdhënie e caktuar me një person e bën atë që të mos jetë i lirë në vendimmarrjet e tij për shkak të konfliktit të interesi. Pra, ashtu sikurse mund të jetë një marrëdhënie e papërshtatshme shoqërore, ashtu mendoj që mund të jetë edhe një marrëdhënie e papërshtatshme në një rreth familjar që nuk përfshihet në rrethin e Kodit të Procedurës Penale për përjashtimin ose për dorëheqjen nga hetimi.

Duke marrë parasysh faktin që koncepti “papajtueshmëri ambientale” është cenuar si një koncept shumë i gjerë i papërkufizuar, menduam që me “papajtueshmërinë etike” ruajmë një koncept të qartë me synimin që ka pasur e gjithë reforma, por bëjmë një ngushtim të rrethit dhe një sqarim të situatës.

Ulsi Manja- Në fakt, koncepti “i papajtueshmërisë ambientale”, kur kemi diskutuar ligje të tjera, jo ligjin e Policisë Gjyqësore që kemi sot, u trajtua në Gjykatë Kushtetuese dhe ishin rastet kur bashkëshortët ushtronin funksionet në të njëjtën strukturë, njëri nga bashkëshortët mund të ishte gjyqtar, tjetri mund të ishte prokuror në të njëjtin nivel, ose njëri nga bashkëshortët prokuror, tjetri ishte oficer i Policisë Gjyqësore. Nuk di pse duhet të japim koncept të zgjeruar të atyre që parashikon Kodi i Procedurës Penale në lidhje me papajtueshmërinë për arsye familjare, gjinie ose krushqie. Pra, Kodi është shumë i qartë. Në rast se në hetimin e një çështjeje penale, oficeri i Policisë Gjyqësore vjen ka lidhje familjare, gjinie, krushqie ose edhe konflikti të pastër interesi me çështjen në hetim, natyrisht atë e detyron Kodi i Procedurës Penale të japë dorëheqjen ose të zëvendësohet. Nuk e di pse duhet ta zgjerojmë?

Pastaj mund të lindë edhe çështja e provueshmërisë. Si do ta provojmë ne që oficeri i Policisë Gjyqësore është në situatë papajtueshmërie etike për shkak të lidhjeve shoqërore? Ai vetë nuk heq dorë nga hetimi, thotë se nuk ka asnjë lidhje me atë subjekt. Ne si do ta provojmë këtë?

Alket Hyseni- Pikërisht çështja e të provuarit është çështje taktike me fotografime, me komunikime telefonike, pra dikë që ai e ka shok dhe është i papërshtatshëm, është e provueshme, por po ashtu, nëse ai ka një marrëdhënie të papërshtatshme me një person që lidhet nga marrëdhëniet familjare ku është jashtë rrethit të personave që parashikon Kodi i Procedurës Penale përsëri është në papajtueshmëri etike për të bërë hetimin. Po rrisim nivelin

e papajtueshmërisë, nga fryma e re që ka gjithë reforma. Kërkojmë një nëpunës shteti me integritet moral, jo me integritet procedural, siç e ka ligji procedural. Atëherë për sa kohë po e kërkojmë për gjyqtar, pse po e bëjmë reformën në sistemin e drejtësisë, po hyjmë edhe në aspekte të integritetit, edhe në lidhjet e papërshtatshme, në të gjitha fushat.

Sa i takon pastaj konfliktit të interesit, është i zgjidhur nga ligji për konfliktin e interesit që duhet futur patjetër. Pra, disa kategori, si “lidhjet e papërshtatshme shoqërore” dhe “konflikti i interesit” janë të padiskutueshme që duhet të jenë në këtë ligj, pa diskutim raportet që burojnë nga gjendja familjare. Ne u kujdesëm t’i fusim për të parë ndonjë situatë të mundshme të paparashikuar nga ligji procedural, por nëse gjykoni se duhet hequr, mund ta heqim, por kjo nuk mund të hiqet. Si do ta provojmë? Koha do ta tregojë këtë rast pas rasti, sepse mund të ndodhë në 1 rast, mund të ndodhë në 100 raste, urojmë që në asnjë rast të mos jetë kjo shkak. Ne duhet ta fusim në ligj në mënyrë që nëpunësi ta dijë, që unë mund të kem edhe familjarë, të cilët nuk m’i kap Kodi i Procedurës si shkak me lidhje të papërshtatshme në situata që më ndikojnë hetimin, sepse për këto raste jemi duke folur.

Kjo ka qenë fryma, prandaj ju ftoj ta miratojmë, sepse është brenda parimeve kushtetuese, por edhe brenda një fryme të re që ka udhëhequr gjithë reformën për të dhënë nëpunës shteti, ekspertë mbase.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

A kanë sugjerime të tjera ekspertët?

Po, zoti Luli.

(Diskutime pa mikrofon)

Kujtim Luli – Konflikti i interesit, i parashikuar te pika 5, e përfshin edhe shqetësimin që anëtarët e komisionit e kanë vendosur te papajtueshmëria etike, pa përfshirë gjendjen familjare. Në vlerësimin tonë parashikimi që bëhet në pikën 5, për papajtueshmërinë etike, është i mjaftueshëm me praninë e konfliktit të interesit brenda përbërjes së këtij parashikimi.

Ulsi Manja – Zoti Luli, kam një pyetje të drejtpërdrejtë. Koncepti “papajtueshmëri etike” a mund të na nxjerrë nesër probleme në gjykim? A mund të jetë një shkak?

Kujtim Luli – Unë nuk shpreha rezerva në tërësi për papajtueshmërinë etike, sepse kam qenë kundër papajtueshmërisë dhe kam arsyetuar pse nuk duhej lënë papajtueshmëria ambientale. Kur pashë termin “papajtueshmëri etike”, i cili është një term i ri edhe në vlerësimin tim, nuk e kam gjetur papajtueshmërinë etike në gjithë veprimtarinë e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, tashmë edhe të Policisë Gjyqësore, por meqenëse ishte një gjetje e komisionit, u mundova ta arsyetoj atë pjesë që bie dukshëm në kundërshtim, që është gjendja

familjare. Sa u takon papajtueshmërive që lidhen me lidhjet e papërshtatshme shoqërore dhe konfliktin e interesit janë për t'u konsideruar.

Ulsi Manja – Dakord.

Pra, sugjerimi është të hiqet për shkak të raporteve që burojnë nga gjendja familjare dhe të ngelet pjesa tjetër e pikës 5 ashtu siç është e formuluar, ky është propozimi.

A janë dakord relatorët që të vlerësohet pjesa “për shkaqe që burojnë nga gjendja familjare” dhe të ngelet pjesa tjetër siç është?

Alket Hyseni – Sa i takon kësaj çështjeje ka pasur diskutime, por për ne nuk ka problem. Unë do të dëshiroja mendimin e ekspertëve që kanë punuar me ne për këtë çështje, ndërkohë, dua të bëj një shpjegim për çështjen e shërbimeve policore që ngriti zoti Luli.

Zoti Luli, këtu kemi të bëjmë me një koncept të vetë strukturës dhe si do të organizohet kjo strukturë në të ardhmen. Pra, nuk flitet vetëm në kuadër të këtij ligji, sepse strukturë hetimore do të ketë policia, jam duke folur për strukturën hetimore për gjithë pjesën e përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila do të përbëhet nga dy komponentë.

E para, do të jenë oficerët e shërbimeve që do të ngarkohen me hetimin. Ne synojmë në të ardhmen, siç është edhe ideja që strukturë hetimore do të ketë vetëm Ministria e Brendshme, ndërsa propozimi i sotëm ishte që të shtohen edhe agjentët. Kjo është në konceptin e të ardhmes, se si do të jetë struktura, në mënyrë që të mos kemi diskutime se çfarë kuptojmë me strukturë hetimore. Kodi i Procedurës e ka në mënyrë koncize, ndërsa ligji i Policisë së Shtetit, si dhe ky ligj, duhet ta shohin në këndvështrimin e plotë se si do të jetë realisht struktura hetimore. Kodi i Procedurës nuk e përkufizon strukturën hetimore që ne të biem ndesh, sepse, po ta përkufizonte, do të kishin të drejtë, por ne nuk mund të dalim mbi një ligj me shumicë të cilësuar. Kodi përmend oficerët e Policisë Gjyqësore dhe ne po ju pyesim se kush janë oficerët e Policisë Gjyqësore? Një nga subjektet janë edhe ata që janë pjesë e strukturës hetimore, pra është një grup shumë më i vogël sesa ai që ka Kodi i Procedurës.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Kjo dispozitë është shumë e mjegullt dhe kam parasysh se në zbatimin konkret të saj do të krijohen probleme. Shumë situata që lidhen me papajtueshmërinë në detyrë, në funksion të oficerit të Policisë Gjyqësore janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Unë jam kundër kësaj dispozite.

Ulsi Manja – E keni fjalën për pikën 5?

Spartak Braho – Po, për pikën 5.

Ulsi Manja – Dakord për pikën 5, por jemi te pika 6, që flet për përkufizimin e fjalës “strukturë hetimore”, në të cilën propozohet të shtohen edhe agjentët. Përkufizimi “agjent i

Policisë Gjyqësore” është dhënë në pikën 2 po të këtij neni, ndërkohë që ka një propozim që të bëhet pjesë edhe e pikës 6.

A ka sugjerime të tjera para se ta hedh në votim?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli - Në filozofinë e këtij ligji duhet vlerësuar që struktura hetimore do të jetë e organizuar me oficerë të Policisë Gjyqësore, të cilët do të ushtrojnë funksionet procedurale penale që i ngarkon Kodi i Procedurës Penale. Agjentët e Policisë Gjyqësore nuk kryejnë funksione procedurale me përjashtim të veprimeve të para hetimore. Veprimet e para hetimore janë deri në momentin kur regjistrohet një procedim nga prokurori. Përbërja e strukturës hetimore me agjentë të Policisë Gjyqësore, sipas vlerësimit tim, mund t’i shërbejë kësaj strukture vetëm për të ekzekutuar urdhërimet e oficerëve për njoftime, për arrestime. Ne duhet të kuptojmë që Policia Gjyqësore e kësaj strukture bashkërendon me strukturat e brendshme të Policisë së Shtetit që i kanë atributet për të kryer atë veprim që kërkohet dhe për ta futur brenda kësaj strukture. Sipas meje është e panevojshme që kjo strukturë të ketë agjentë, pasi të gjitha strukturat e tjera të Policisë së Shtetit janë në funksion të kësaj strukture kur urdhërohen për të kryer veprime të karakterit ekzekutiv, siç mund t’i kryejnë edhe agjentët e Policisë Gjyqësore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

Edhe unë jam dakord me sugjerimin tuaj. Ne nuk kemi absolutisht të drejtë që në një ligj të thjeshtë të zbërthejmë konceptet që ka Kodi i Procedurës Penale. Është i mjaftueshëm përcaktimi që keni bërë në pikën 2 për termin “agjent i Policisë Gjyqësore”, ndërsa Kodi i Procedurës Penale, në nenet 30, 31 dhe 32 e ka të qarë se cilat janë funksionet e Policisë Gjyqësore, por edhe cilat janë shërbimet e Policisë Gjyqësore. Për mua është i mjaftueshëm përcaktimi në pikën 2 të nenit 2.

Te pika 6 e shikoj të tepërt të futet si strukturë hetimore dhe koncepti i agjentit të Policisë Gjyqësore. Policia e Shtetit në bazë të ligjit të saj organik ka të drejtën të miratojë çdo lloj strukture, por funksionet hetimore derivohen nga Kodi i Procedurës Penale.

Ju falënderoj për përfshirjen në diskutim. Te pika 5 edhe me mirëkuptimin e relatorëve, të hiqet paragrafi: “Për shkak të raporteve që burojnë nga gjendja familjare”. Neni 2 në tërësinë e tij duket i qartë në këtë pikë.

Përshtatshmëri, papajtueshmëri etike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni - Doni një shembull tipik që nuk e ka Kodi i Procedurës Penale? Ai përgjithësisht natën me një subjekt të hetimit dhe këtej e heton, është një rast që nuk e ka Kodi i Procedurës, është papajtueshmëri për shkak të rrethanave shoqërore apo jo?

Ulsi Manja - I bie ta hapim kot si diskutim. Nëse do të hiqet edhe “papërshtatshmëria shoqërore” ose “konflikti i interesit”, më mirë të hiqet komplet pika 5. Nëse bie edhe kjo e lidhjeve të papërshtatshme shoqërore, i bie që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka sugjerime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votim. Kush është dakord me nenin 2 për ndryshimet që i bëhen pikës 5, duke hequr fjalët “për shkak të raporteve që burojnë nga gjendja familjare?”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Përkufizimet.

Kalojmë te neni 3. “Parimet në ushtrimin e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore”

Grua – Neni 3 është riformuluar sipas tabelës që kanë deputetët përpara. Janë renditur në njëfarë mënyre parimet bazë që Policia Gjyqësore do të ketë parasysh në ushtrimin e funksionit të saj.

Ulsi Manja – Ka vërejtje për nenin 3?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli - Unë sugjeroj një redaktim, te pika 1 në mbylljen e fjalisë thuhet: “këto parime”. Parimet përsëriten në çdo pikë. Për mua është e panevojshme përsëritja: parimi i ligjshmërisë, por të thuhet: ligjshmëria, barazia dhe mosdiskriminimi. Të thuhet: objektiviteti dhe janë ato parime, pa i përsëritur: parimi, parimi.

Plus kësaj kam edhe një sugjerim që të shtohet kontrolli dhe llogaridhënia. Parimin e kontrollit dhe të llogaridhënies i çmojmë të domosdoshëm për t’u parashikuar në këtë nen, si parime në ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore për sa i përket zbatimit të nenit 33, në lidhje me nenin 7 edhe të këtij projektligji, por duhet të kujtoj se ky parim është i parashikuar edhe në nenin 4 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në nenin 5 të ligjit nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Duke qenë pjesë organike e ligjeve përkatëse, të jetë pjesë edhe e këtij ligji, që bën fjalë për shërbimet e Policisë Gjyqësore dhe seksionet e kësaj të fundit.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni- Ka qenë propozimi, e kemi diskutuar gjatë në grupin e punës, argumenti që ngrihet është në të kundërt të idesë për t'u futur këtu. Parashikimi në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe në ligjin “ Për Policinë Ushtarake” nuk është i barasvlefshëm me oficerin e policisë, se nuk ka të njëjtat parime oficeri i Policisë Gjyqësore me oficerin e Policisë së Shtetit dhe me oficerin e Policisë Ushtarake, ata patjetër që kanë kontrollin dhe llogaridhënien. Këtu ka parimin e ligjshmërisë, i ka të parashikuara në ligj, në Kodin e Procedurës. Ne këtë duam që të sjellim, ta heqim konceptin policesk të oficerit të Policisë Gjyqësore. Nëse e ka dëmtuar hetimin deri sot, ka qenë ideja e oficerit të Policisë Gjyqësore që anonte nga koncepti policor dhe jo nga koncepti procedural, gjë që nuk ka sjellë një hetim profesional. Këto parimet bazë që kemi renditur ne dhe një tjetër që e shtuam me sugjerimin e OSBE-së, që ka qenë parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut janë të mjaftueshme, janë parimet bazë që i shërbejnë, kuptohet pa u kufizuar, sepse buron nga Kushtetuta, tërësia e parimeve burojnë nga Kushtetuta. Ne renditëm ato që shkojnë më afër funksionit të oficerit të Policisë Gjyqësore. Unë kam mendimin të qëndrojmë në këtë përkufizim.

Ulsi Manja - Ka propozime të tjera për këtë nen? Jemi te parimet.

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – Ne e kaluam këtë pjesë, ka të bëjë me papajtueshmërinë etike. Mendoj se është i rëndësishëm si koncept dhe duhet të ruhet ideja që oficeri nuk duhet të kryejë veprimtari të tilla që nuk parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, por shikoj se ai nuk përmendet në asnjë vend tjetër në ligj. Pra, ndërkohë që mendoj se duhet të ruhet si parim, duhet të ketë edhe parashikime specifike më tej në projektligj.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Pra, ishte për pikën 5, në mos gaboj te përkufizimet. Zoti Luli për nenin 3, në lidhje me parimet, propozon të jetë edhe parimi i kontrollit dhe i llogaridhënies.

Kujtim Luli – Kam edhe një koment plus. Duhet të kemi parasysh raportet e Policisë Gjyqësore, duke filluar nga prokurori i çështjes, drejtuesi i prokurorisë dhe deri te Prokurori i Përgjithshëm.

Këto lloj marrëdhëniesh, që Policia Gjyqësore ka me prokurorinë janë edhe për çështje konkrete, po edhe për veprimtarinë e Policisë Gjyqësore. Kështu, është e rëndësishme që ky parim të jetë pjesë e këtij ligji, për të përmbushur këto detyrime që i parashikojnë vetë dispozitat në vijim të këtij ligji. Parashikohen marrëdhëniet e varësisë e të mbikëqyrjes së Policisë Gjyqësore nga ana e prokurorëve.

Atëherë, me çfarë rregullohen këto marrëdhënie, në lidhje me mënyrën e kontrollit e të mbikëqyrjes së veprimtarisë. Me këtë parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Propozimi është ky: zoti Luli propozon që, përveç këtyre parimeve që janë te neni 3, të shtohet edhe një parim, që është parimi i kontrollit dhe i llogaridhënies.

Ju lutem, ndizeni mikrofonin, zoti Braho!

Spartak Braho – Kontrolli dhe llogaridhënia janë respekt procedural. E tërë veprimtaria e oficerëve të Policisë Gjyqësore është veprimtari procedurale. Tashti mund të vëmë edhe vijën e masave e të tjera e të tjera, por nuk shkojnë.

Ulsi Manja – Pra, zoti Braho thotë se nënkuptohet kontrolli dhe llogaridhënia në procesin e hetimit, në lidhje me raportet prokuror-oficer i policisë gjyqësore, sepse raport kontrolli dhe llogaridhënieje është ai.

Alket Hyseni – Më lejoni, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Në mbështetje të zotit Braho, janë disa dispozita ku ne e sqarojmë edhe mënyrën e varësisë, edhe llogaridhënien, por nuk hyjnë te parimet bazë, përveç parimit të ligjshmërisë. Ne duam të japim koncept procedural, jo koncept ushtarak për oficerin e Policisë Gjyqësore. Kjo ka qenë ideja.

Ulsi Manja – Ju lutem, nuk besoj se është koncept ushtarak, por gjithsesi, mendoj se është e tepërt të shtohet si parim.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Neni 3, ka pika 1, a, b, c, d e të tjera me radhë, por po të themi pikën “a”, parimi i ligjshmërisë, aty mbështillen të gjitha. Pse duhet t’i cilësojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino!

Bashkim Fino – Ke parimin e ligjshmërisë, i ke të gjitha brenda. Çfarë problemi ka?

Ulsi Manja – Dakord!

Nuk ka sugjerime të tjera. Është një sugjerim, që për efekt çështjesh të teknikës legislative, biem dakord të hiqet përmendja e fjalës “parim” në të gjitha germet e këtij neni. Sa i takon sugjerimit të zotit Luli, për t’u shtuar si parim kontrolli dhe llogaridhënia, edhe unë bie dakord me mendimin e shumicës së kolegëve, që parimi i ligjshmërisë i nënkupton të gjitha, aq më tepër se veprimtaria hetimore është veprimtari dinamike. Patjetër që raportet e prokurorit me oficerin e Policisë Gjyqësore janë raporte kontrolli e llogaridhënie. Në fund të fundit, çfarë ka oficeri i Policisë Gjyqësore në hetim: do të japë llogari për respektimin e afateve të hetimit, kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara apo të deleguara nga prokurori. Patjetër që

kuptohet se këtë veprimtari e disiplinon Kodi i Procedurës penale, duke u nisur nga parimi i ligjshmërisë.

A jemi dakord me nenin 3, me këtë formulim të teknikës legislative?

Ka ndonjë sugjerim Ministria e Mbrojtjes?

Ardit Hysa – Në lidhje me sugjerimin e zotit Luli, desha të tërhiqja vëmendjen se, në kuadër të Kodit të Procedurës Administrative, kur merret me të drejtat themelore të individëve, kontrolli ka dy faza: kontrolli gjyqësor dhe kontrolli administrativ. Ky është një parametër që ta jep Kodi i Procedurave Administrative. Në qoftë se këtu supozohet të krijohet një strukturë hetimore, atëherë marrëdhënia e prokurorit mund të jetë shumë mirë me strukturën. Domethënë, në qoftë se ka një strukturë qendrore dhe një strukturë vendore, prokurori komunikon me strukturën, dhe struktura brenda vetes duhet të rregullohet. Kështu që, nuk shikohet siç është tani, kur prokurori delegon një individ të caktuar. Kur nesër pasnesër struktura hetimore, qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel vendor, të marrë Policinë e Shtetit, duhet të jetë në gjendje të kontrollojë veprimet e individëve që ka poshtë.

Ulsi Manja – Po, zoti Peçi!

Më duket se po ngatërrojmë ligjin “Për Policinë Gjyqësore” me ligjet organike të agjencive që kanë ardhur sot këtu.

Idlir Peçi – Pikërisht!

Ulsi Manja – Para se të vazhdoni, zoti Peçi, ky është ligj-kuadër, i cili derivon nga Kodi i Procedurës Penale. Të mos e harrojmë për asnjë moment këtë. Nuk jemi këtu për të rregulluar as ligjin “Për Policinë Ushtarake”, as ligjin “Për Policinë e Shtetit”, por jemi për të bërë ligjin “Për Policinë Gjyqësore”. Baza e këtij ligji është Kodi i Procedurës Penale. Mos harroni se më 1 gusht të vitit 2017 ka hyrë në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, dhe themelet e këtij ligji që po diskutojmë sot janë hedhur në këtë kod.

Çfarë po bëjmë ne sot? Po zbërthejmë katër nene të Kodit të Procedurës Penale: nenet 30, 31, 32 dhe 33 të Kodit të Procedurës Penale. As më shumë e as më pak, këto katër nen kemi zbërthyer në këtë ligj. Natyrisht, ky është ligj që merret edhe me organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, por është edhe procedurë.

Po, zoti Peçi.

Idlir Peçi – Po i rikthehem nenit 2, pavarësisht se është, por thjesht për të sqaruar strukturën hetimore. Struktura hetimore, siç e thotë edhe pika 6, është pjesë e strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pse duhet të krijohet një strukturë e veçantë hetimore? Ideja është se, duke marrë shkas nga problemet e hasura në hetim përgjatë viteve, kur të gjithë oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore, që lëviznin në çdo moment të caktuar të hetimit, pa

pasur një komunikim me prokurorin, sillnin paqëndrueshmërinë e hetimit. Kjo do të thotë se në çdo moment, një drejtor policie apo strukturat e Policisë së Shtetit mund të dëmtonin hetimin penal, duke lëvizur pa kriter dhe duke lëvizur shpeshherë pa lajmëruar edhe prokurorët. Pra, ata agjentë apo oficerë të Policisë Gjyqësore, të cilët mund të ishin duke kryer një hetim në lidhje me një çështje të caktuar.

Ideja nuk është se do të krijohet një strukturë qendrore, një strukturë vendore etj. dhe në ligj është përcaktuar “strukturë hetimore”, një term i cili është fleksibël. Pra, është përdorur një terminologji i lejon fleksibilitete dhe Policisë së Shtetit, me apo pa ndryshimin e ligjit të vet organik, për të pasur një trupë oficerësh, që unë prapë jam i mendimit se duhet të jenë edhe agjentë të Policisë Gjyqësore, të cilët të merren vetëm me hetimin. Pra, të kenë atributet e Policisë Gjyqësore dhe të merren vetëm me hetimin, në mënyrë që një drejtor apo kushdo qoftë, të mos ketë mundësi t’i lëvizë në mes të një hetimi, pa asnjë lloj kriteri, pa njoftuar prokurorin, duke dëmtuar kështu hetimin. E para kjo.

E dyta, ideja është që prokurori të ketë në çdo prokurori rrethi apo në çdo prokurori të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë të ketë në dispozicion shërbimet e Policisë Gjyqësore, pra shërbimet e Policisë së Shtetit, sepse, duam apo jo, Policia e Shtetit është ajo që kryen shumicën e hetimeve penale në Shqipëri dhe në çdo vend tjetër. Kjo do të thotë që të mos ketë nevojë prokurori të varet nga policia, për shembull prokurori i Përmetit t’i kërkojë policisë së Gjirokastrës t’i çojë një agjent apo një oficer të Policisë Gjyqësore, sepse në Prokurorinë e Përmetit nuk ka një oficer të Policisë Gjyqësore. Këto situata duhet të rregullohen. Prandaj është koncepti i strukturës. Kjo do të thotë se në çdo prokurori do të ketë një shërbim, i cili do të jetë pjesë e një strukturë. Mund të imagjinohet një strukturë me një drejtor ose edhe si një strukturë fleksible brenda Policisë së Shtetit. I takon kësaj të fundit ta organizojë atë qoftë me ligjin e vet organik apo me akte nënligjore. Pra, ideja është të shkëputet varësia nga policia apo nga politika, ku një oficer i Policisë Gjyqësore lëvizte dhe krijonte paqëndrueshmëri të hetimit. Kjo është e gjithë ideja. Për këtë arsye, unë përsëri këmbëngul (zoti Manja e di, sepse e kemi diskutuar, që thoshin se agjentët nuk duhet të jenë) që agjentët duhet të jenë, sepse krijohet përsëri një artificializëm. Ndahet informacioni operativ nga informacioni, që mbledhet në kuadër të hetimit penal në përforcimin dhe qëndrueshmërinë e hetimit penal. Kam përshtypjen se do të krijohet një artificializëm nëse nuk i futim. Megjithatë, kjo është për nenin 2, kurse për strukturën në përgjithësi ishte ky lloj shpjegimi, që ky diskutim të mos bëhet më vonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Peçi!

Jemi te votimi i nenit 3.

Nenin 2 ne e votuam. Pikat 2 dhe 6 i shoh në harmoni me njëra-tjetrën dhe nuk besoj se krijojnë probleme, nëse lexohen në mënyrë dinamike, siç janë të përcaktuara në nenin 2.

Neni 3. A biem dakord që të hiqet fjala “parim” dhe ta votojmë kështu siç është? Kush është pro? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4 “Subjektet që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore”.

Elena Xhina – Po, zoti kryetar, neni 4 parashikon subjektet që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore, por ka një riformulim të tij. U propozoj kolegëve ta votojnë sipas variantit të paraqitur.

Ulsi Manja – A ka sugjerime për nenin 4? Në fakt, neni 4 buron direkt nga Kodi i Procedurës.

Po, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Kam një pyetje që ka të bëjë me konceptin e përgjithshëm të ligjit dhe të organizimit të Policisë Gjyqësore dhe të hetimit në përgjithësi. Me sa shoh unë, me këtë zgjidhje definitive që i jepet projektit, kemi dy qëndrime: në rastin e SPAK-ut, pra të Prokurorisë Speciale dhe të BKH-së, kemi trupën e prokurorëve dhe një trupë policore të hetimit në funksion të prokurorisë; për pjesën tjetër të prokurorisë kemi një zgjidhje tjetër. Pra, kemi dy trupa hetimi të Policisë Gjyqësore: njëra që u atashohet prokurorëve dhe tjetra që rri në Policinë e Shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Koncepti ka qenë për të krijuar një strukturë të posaçme hetimore, gjë që i mungon sot efektivisht Policisë së Shtetit, pa hyrë te problematika që ka hetimi, që është “thembra e Akilit” të policisë dhe ka vite që nuk është rregulluar, duke krijuar efektet e problematikave që kemi aktualisht. Pa u zgjatur te kjo çështje, ajo që më ka shqetësuar personalisht gjithmonë dhe që ka qenë një diskutim i madh edhe gjatë procesit të reformës në drejtësi, që pata rastin ta shoh edhe gjatë kohës kur shërbeva në Ministrinë e Brendshme, është dualizmi ndërmjet oficerëve të policisë në seksionet pranë prokurorive dhe atyre që shërbejnë në hetimin e strukturave hetimore në Policinë e Shtetit. Oficerët e Policisë Gjyqësore, ta themi troç, në seksionet pranë prokurorive në shumicën e rasteve shërbejnë si sekserë të prokurorëve. Pra, nga mënyra se si është e organizuar ata kanë shërbyer kryesisht për të zgjidhur çështje të raportit të prokurorëve me klientët, me subjektet, më shumë se për hetime profesionale. Kur kanë dashur prokurorët që t’ia kalonin përgjegjësinë Policisë së Shtetit, ia kanë deleguar asaj. Kur kanë dashur t’i kishin në kontroll çështjet, e kanë mënjeluar policinë. I ndërtuar në këtë

mënyrë, ky lloj dualizmi, këtu kemi pasur parasysh edhe faktin që kemi një ndryshim substancial të mënyrës se si funksionon sot prokuroria, ku roli procedural i prokurorit është krejt i ndryshëm nga ai i mëparshmi në raportet që kishte me eprorët e tij, nuk do të japë efektin e kërkuar, por mund ta përkeqësojë. Unë dëshiroj të kuptoj nga ata që janë marrë me projektin: sa e kanë marrë në konsideratë këtë gjë?

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Shqetësimi i zotit Xhafaj nuk është pa bazë. Unë dhe kolegët e grupit të punës e kemi ngritur shqetësimin që shkallëzimi aktual i oficerëve mund të qëndrojë apo mund të shuhet. Por të gjithë diskutantët në grupin e punës kanë vërejtur që, për shkak të praktikës hetimore, është e pashmangshme të ketë të paktën dy kategori, sepse kemi edhe një kategori tjetër, ku janë edhe institucionet e tjera. Për shembull, hetimi doganor, hetimi tatimor, policia ushtarake, që ne e futëm me kërkesë të Ministrisë së Mbrotjtjes. Pse u gjykua se duhet të rrinë, edhe pse ka një risk të zbatimit të keq të ligjit?! Sepse risku që përmendi zoti Xhafaj është risk i papërgjegjshmërisë së një personi apo të personave të caktuar. Ideja është që një pjesë të hetimeve i nis policia, madje në një masë dërmuese dhe, bazuar në kërkesat e Kodit të Procedurës, e përcjell në prokurori. Prokurori delegon detyra ndaj policisë, ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore, pra në shërbimet e policisë, por edhe ndaj oficerëve të policisë në seksione dhe në veprime të ndryshme, si për shembull, ndjekjen e akteve të ekspertimit, të cilat i ndjekin oficerët e policisë së seksioneve pranë prokurorive, ndërsa veprimet më të thella hetimore, si: vëzhgime operative, marrje informacionesh nga terreni dhe nga zonat nga kontrollet i kryejnë oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve policore, por gjithmonë nën orientimin e prokurorit.

Ne kemi bërë një Kod të ri Procedure, një organizim të ri të sistemit të prokurorisë, i kemi dhënë pavarësi prokurorit, sido që t'ia lëmë oficerin e Policisë Gjyqësore, me tagrat dhe pavarësinë që ka prokurori sot, nëse e keqpërdor, nuk ka ligj që do ta kornizojë veprimtarinë e tij. Kështu që, zoti Xhafaj, pavarësisht shqetësimit që ne e kemi diskutuar, ne jemi para një zgjidhjeje praktike të pashmangshme kategorizimi të subjekteve pranë prokurorisë dhe pranë policisë, të cilat janë dy strukturat kryesore. Duhet të kemi parasysh që numri nuk është i madh, por është një numër prej 160 oficerësh të Policisë Gjyqësore në sanksione, e cila, me të gjithë kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme, mund të ketë një rritje për shkak të rritjes së volumeve, por nuk shkon më shumë se 200. Baza janë shërbimet policore, ku në strukturën hetimore do të jenë së paku 2000 persona.

Ulsi Manja – Po, zoti Peçi.

Idlir Peçi – Për sa i përket shqetësimit të drejtë që ngriti zoti Xhafaj, edhe unë i bashkohem asaj që tha zoti Hyseni. Kur EURALIUS 5 u fut në këtë projektligj, duke qenë në unison edhe me partnerët e tjerë, sidomos me PAMECA-n apo këshilltarët gjermanë, e pamë me skepticizëm këtë dualizmin ndërmjet seksioneve dhe shërbimeve, sepse kjo situatë ka krijuar paqëndrueshmëri dhe shqetësime, që zoti Xhafaj i përmendi, i cili i di më mirë edhe nga pozicioni i tij në krye të Ministrisë së Brendshme. Gjatë gjithë diskutimeve që kemi pasur në grupin e punës, të paktën ne si EURALIUS, i kemi ngritur gjithmonë dhe kemi dhënë alternativa si, për shembull, që në seksionet e prokurorisë të shikohet mundësia dhe të bëhen ndihmësprokurorë, sepse aty futet edhe aspekti human për ata 160-200 persona, të cilët dalin në rrugë. U pa mundësia që ata njerëz duhet të sistemohen diku, të cilët mund të lihen si asistentë\prokurorë ose diçka tjetër, por që zgjidhja u dha në nenet 24 dhe 25 të këtij projektligji. Ndoshta duhet të ketë një rregullim më të mirë kur të vijmë te neni 24 i këtij projektligji, sidomos në pikën 2 dhe të shmanget ajo që tha zoti Xhafaj, që të mos kemi prokurorinë, e cila mënjanon shërbimin që i intereson prokurorisë me shërbimin nga hetimi. Ndoshta aty duhet parë më me kujdes kur thuhet se në raste të veçanta për të garantuar objektivitetin e hetimit prokuroi mund të përdorë oficerët e shërbimeve të tjera të seksioneve të Policisë Gjyqësore për të kryer hetimet.

Ulsi Manja – Zoti Braho ka diçka për të shtuar.

Spartak Braho – Unë nuk kam për të shtuar diçka, por kam për të shtuar shumë. Ajo që unë konstatoj dhe që e dinë të gjithë këtu që janë juristë është që kjo dispozitë është njësoj siç ka qenë para 10 ose 12 vjetësh, nuk ka ndonjë ndryshim. Ne vazhdojmë të mbajmë ende këmbët hapur dhe nuk përcaktojmë realisht funksionet konkrete dhe varësinë konkrete të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Në germën “b” thuhet: “Punonjësit e Policisë së Shtetit janë pjesë përbërëse e strukturës hetimore”. A jemi të saktë deri këtu?

Alket Hyseni – Jo, thuhet “Të cilët janë pjesë e strukturës”. Pra, është pjesa e punonjësve të policisë që janë në strukturë. Prandaj ne shpjeguem se cila është struktura hetimore...

Spartak Braho – Unë jam i parimit që duhet të përcaktojmë më mirë se kush do të kryejë hetime. Kushtetuta ka përcaktuar një organ për kryerjen e hetimeve, që është prokuroria, e cila, përveç hetimeve, paraqet edhe akuzën në gjyq.

Ulsi Manja – Po, zoti Luli.

Kujtim Luli - Unë kam një koment të shkurtër dhe dy propozime për përmirësimin e germave “b” dhe “c”.

Alket Hyseni – Më falni, a mund të flas për procedurë?

Ulsi Manja- Po.

Alket Hyseni – Zoti Luli dhe zoti Beluri, në cilësinë e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme, kanë qenë në grup pune dhe nuk mund të hapim sot diskutimet që janë bërë në 30 mbledhje. Çdo propozim që ju keni pasur, pothuajse, është futur dhe propozim për këtë nene nuk kemi pasur. Megjithatë, unë ju sugjeroj që të mos ngatërrojmë funksionin e komisionit, sepse nuk mund të rihapim diskutime, që, në fund të fundit, i kemi mbyllur. Unë e thashë se ne kemi pasur vetë në grup mendime të ndryshme, qoftë edhe për një fjali, por kemi konkluduar në një fjali më parë.

Ulsi Manja - Të lutem, zoti Hyseni!

Gjithsesi, nuk jemi për një proces mekanik, prandaj është diskutimi në komision, sepse përfshihen edhe kolegët e tjerë në diskutim. Grupi i punës ka qenë me dy relatorët dhe me ekspertët, por nuk mund t'ua heqim mundësinë edhe kolegëve të tjerë, prandaj është diskutimi në komision. Por gjithsesi të jemi racionalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjatë diskutimit me grupin e punës mund të jetë harruar ndonjë gjë teknike apo ndonjë propozim konkret. Kështu që ne sot nuk do ta kalojmë të gjithë projektligjin. Ne do të ecim me kujdes në miratimin e secilit nga këto nene të këtij projektligji, nuk kemi ngutje, e rëndësishme është të kemi një produkt final të pranueshëm, që të jetë në harmoni të plotë me Kodin e Procedurës Penale dhe të mos ketë probleme në zbatimin në praktikë nesër të këtij ligji. Kështu që unë bashkohem me sugjerimin tuaj për procedurë, për efikasitet të punës në komision, por nuk do ta kufizojmë debatin.

Ju lutem, zoti Luli, na thoni propozimet konkrete në lidhje me nenin 4, germet “b” dhe “c”.

Kujtim Luli – Në germën “b” thuhet: “Punonjësit e Policisë së Shtetit”. Unë sugjeroj të jetë “Oficerët e shërbimeve të Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës”, pra në terminologji shkon në përjasje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në germën “c” me slash janë vendosur punonjësit, por mund të vendosen edhe hetuesit, që neni 30 i Kodit të Procedurës Penale në pikën 3, të thotë: “Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë cilësinë e oficerëve të Policisë Gjyqësore”, për ta përafëruar me nenin 30, pikën 3 të vendoset slash-i, pas punonjësit, hetuesit e Policisë së Shtetit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në nenin 30, pika 3, thuhet: “Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore”. Kështu që punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit nuk e kanë statusin.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Ju lutem, nuk po themi punonjësit dhe nuk po e shpjegojmë, por po themi: “punonjësit, të cilët kanë statusin”. Tani, se cili e ka statusin, e ka ligji specifik. Ne duam të bëjmë një ligj që t’i qëndrojë kohërave. Në rast se ligji specifik ndryshon nesër, ne këtu kemi termin e përgjithshëm dhe themi: “Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kanë statusin e oficerëve”. Në germen “b” thuhet: “Punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës hetimore”. Ne nuk duam të bëjmë disa gjëra, që kushtëzojnë të gjithë pjesën tjetër të shtetit. Ky është ligji kuadër, ligji bazë, por se cilat janë funksionet, ato i përcaktojnë ligjet e veçanta.

Me kërkesën e OPDAT-it e kemi futur Byronë në dy aspekte, këtu tek trajtimin financiar, dhe nuk jemi marrë më, sepse i ka ligji specifik.

Po ashtu për Policinë e Shtetit nuk jemi marrë me detaje në cilësinë e oficerit të policisë, sepse janë në ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Zoti Luli, prandaj e thashë se ne ramë dakord në grup për këtë term. Termi “hetues apo punonjës”....

Ulsi Manja – A ka sugjerime të tjera?

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Me aq sa shikoj, relatorët bashkë me grupin e punës kanë bërë goxha punë gjatë gjithë kësaj kohe, por përsëri në mbledhjen e parë nuk biem dakord dhe përsëri rikthehemi te diskutimi i parë.

Zoti kryetar, mbledhja e komisionit është për ne dhe për ju, nuk është për këta. Këta kanë diskutuar, kanë ridiskutuar dhe kanë sjellë një draft, që na e keni lënë përpara, drafti i ligjit dhe atë çka kanë arritur në një konkluzion, dhe në bazë të këtyre konkluzioneve duhet të diskutojmë. Domethënë, duhet të na lësh pak më shumë kohë neve. Për shembull, unë e mbështes mendimin e zotit Xhafaj për shqetësimin që sapo ngriti. Nuk jam jurist, por me aq sa e lexoj ligjin, kuptoj në funksionet e Policisë Gjyqësore do të ketë oficerë të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, do të ketë punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës, pjesa që krijohet e re dhe pjesa që ka të bëjë me doganën e të tjera me radhë. Pyetja ime është: seksionet pranë prokurorisë, a do të ekzistojnë? Kur ti thua: “punonjësi i Policisë së Shtetit do të jetë pjesë e strukturës hetimore”. Në qoftë se do të ekzistojë, pse duhet të ekzistojnë dy gjëra, edhe ata që ka prokuroria, edhe këta? Nga pikëpamja funksionale dhe profesionale ata do të varen nga prokurori, me çfarë lexuam në nenet e para, nga pikëpamja administrative mund të jenë nga Ministria e Brendshme, por pak rëndësi ka.

Me atë që tha eksperti Peçi, më la të kuptoj se me strukturën e re nuk ka më devijime, polici gjyqësor do të jetë në funksion të prokurorit të çështjes, apo jo dhe nuk mund ta lëvizë dot do as ministri, as drejtori e të tjerë me radhë. Tani, pse ne duhet të kemi dy struktura?! Sa veta të strukturës janë të prokurorisë, 100, 150 apo 200, që janë sot? Çfarë do të bëjmë ligj për 100 apo 200 veta ne këtu?! Ose të bëjmë një ligj tamam ata persona 100 le të shkrihen te kjo pjesa e strukturës hetimore, në fund të fundit, ose të ketë vende të tjera, le të bëhen prokurorë, le të bëjnë çfarë të duan, nuk e di. Në qoftë se ju mendoni të bëni ligj për 100 veta apo 200 veta, duke lënë germën “a”, bëni gabim, dhe këtë e kam më shumë me relatorët. Ne duhet të bëjmë një strukturë të Policisë Gjyqësore, për atë të cilën zoti Peçi e tha shumë mirë, të mos kemi më probleme, siç kemi pasur deri tani në këtë çështje.

Këtu kam një pyetje konkrete për ju, zoti Hyseni, si relator apo ndoshta edhe për këta që janë të pranishëm këtu. Pse duhet të jenë të dyja këto, edhe seksioni pranë prokurorisë, edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, për të cilët ne e bëjmë këtë ligj? Nuk e kuptoj. Në qoftë se ma mbushni mendjen, do të votoj. Në të kundërt, nisur nga eksperiencia personale që kam, unë nuk mund të bëj ligj për 100 veta, ligjin e bëj për më shumë njerëz, për të diskutuar dhe për të pasur një vendimmarrje, që të jetë sa më afër njerëzve, pra nuk e bëj për 100-200 veta, se ne nuk kemi bërë ligj as për 140 deputetët, po bëkemi ligj ne për 200 prokurorë, që do të quhen ndihmës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Hyseni, ju lutem, shkurtimisht një përgjigje.

Alket Hyseni – Zoti Fino, më lejoni, së pari, që t’ju shpjegoj se ligji nuk është vetëm për këtë trupë. Kjo është një nga trupat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më e vogla nga trupat, që ne e kemi gjykuar të domosdoshme për nevojat e tij. Ne nuk mund t’a heqim prokurorit me mekanizma, që janë të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

Ashtu siç janë në atë institucion, ai numër që përmenda, që e tha edhe eksperti, si një nga argumentet atë që nuk është argument thelbësor, se do t’i rregullojmë, pasi nuk kemi ku t’i çojmë ata 160. Ai ishte një nga argumentet fundorë madje. Argumenti bazë është ai procedural, që ndihmon hetimin. Ky ligj do të përmirësojë dukshëm hetimin në Republikën e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo do të bëjë që prokurori për nevojat e shpejta nuk ka nevojë t’i nisë shkresë komisariatit të policisë për të caktuar disa detyrat ndaj oficerit të policisë, që është në shërbimet

e policisë, por e ka aty, brenda institucionit, oficerin e tij që ia lë detyrat në moment dhe ai vepron menjëherë.

Ato detyra që ai mund t'i kryejë. Nëse ka ngarkesë, patjetër që pastaj ia çon oficerit të Policisë së Shtetit, oficerit doganor, oficerit të hetimit tatimor ose oficerit ushtarak në rastet e krimeve ushtarake e me radhë.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Ja, ta mbaroj!

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, nuk e thashë ashtu.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, unë thashë që nuk duhet...

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Patjetër, or, ngarkesë...

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Zoti Fino, më lejoni ta mbaroj fjalën! Ju lutem!

Ulsi Manja – Ju lutem, më lejeni ta mbarojë!

Alket Hyseni – Zoti Fino, ne nuk mund të bëjmë një ligj ku të parashikojmë, për shembull, që Alket Hyseni do ta respektojë ligjin me shejtanllëk. Ka mekanizma të tjerë kontrolli ndaj prokurorit, i cili kur vepron në shkelje të ligjit, jep llogari.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

I thjeshtë.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

(Diskutime në sallë)

Bashkim Fino – Unë jam kundër kësaj.

Alket Hyseni – Dakord.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Xhina, ju lutem, një koment të fundit.

Elena Xhina – Zoti Fino, ndarja në shërbime dhe në seksione parashikohet edhe në Kodin e Procedurës Penale. Ligji që do të miratojmë ne sot qëndron mbi ligjin që në hierarki dhe konkretisht në nenin 31 të tij. Kështu që nuk mund ta evitojmë ndarjen nëse Kodi i Procedurës Penale zbatohet dhe është në fuqi sot.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Elena Xhina – Pra...

Bashkim Fino – Nuk e dëgjova, sepse po lexoja atë që më the ti, se e ka Kodi i Procedurës Penale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e ka Kodi i Procedurës Penale, nuk ke pse ta vësh këtu, mund ta lësh vetëm atje.

(Deputeti Fino ndërhyn pa mikrofon.)

Për diskutim e kemi, se për ne bëhet ligji, nuk bëhet për këta, se ju me këta keni folur prej një muaji e ca. Duhet të më mbushësh mendjen mua që ta votoj!

Lidhur me shërbimet dhe seksionet e Policisë Gjyqësore thuhet se funksionet e Policisë Gjyqësore kryhen nga: a) oficerët e Policisë Gjyqësore, që u përkasin organeve, të cilave ligji u ngarkon detyrën për të kryer hetime që nga çasti që marrin dijeni për veprën penale dhe b) nga seksioni i policive gjyqësore të krijuara pranë çdo prokurorie” e të tjerë. Këtu kanë të drejtë këta të thonë: “Jo, e kemi në Kodin e Procedurës Penale, do ta mbajmë!” Apo e kam gabim, flas në kontekst? Atëherë, po e heqim nga këtu dhe e bëjmë tamam që...

Alket Hyseni – Nuk e heqim...

(Deputeti Fino ndërhyn pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Policia Gjyqësore të jetë një dhe të jetë në funksion të prokurorisë.

(Deputeti Hyseni ndërhyn pa mikrofon.)

Jo të jetë një pjesë e prokurorisë, kurse një pjesë tjetër të jetë e policisë.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem!

Bashkim Fino – Nejse, ky është koncepti im, por është e drejta ime të shprehem. Demokraci është sot dhe është e drejta ime të flas me këtë gjuhë. Pra, më takon të flas dhe kështu e kuptoj, madje i qëndroj fort...

Deri tani as ju, nuk e di se çfarë do të thotë zonja Xhina, nuk ma keni mbushur mendjen për këtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Singerisht nuk e kuptoj tani, në fakt, edhe nga ekspertët dhe nga të pranishmit, që janë marrë me draftimin e këtij ligji, debatin për një nen, i cili do të duhej të ishte transpozim direkt në ligj i dispozitës së Kodit të Procedurës Penale.

Debati dhe diskutimi me përfaqësuesit e Policisë së Shtetit ka qenë dhe vazhdon të jetë vetëm një: Kodi i Procedurës Penale e ka ndarë seksionin e Policisë Gjyqësore më vete dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore më vete.

(Diskutime në sallë)

Për sa i përket diskutimit: a duhet të ketë seksion të Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë?, e ka Kodi, por ka edhe një përgjigje përse do të duhet të ruhet seksioni, se mirë këto institucione që janë këtu dhe që ligji organik i ka dhënë attribute Policisë Gjyqësore, po institucionet e tjera, që nuk kanë trupë hetimore në dispozicion? Po marr shembull Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kush do t'i hetojë kallëzimet e këtij institucioni në prokurori? Patjetër që oficerët e Policisë Gjyqësore të seksionit të prokurorisë, sepse kjo trupë hetimore në dispozicion të prokurorisë është për të ofruar një shërbim të Policisë Gjyqësore për ato institucione që ligji organik nuk u ka dhënë atributet e hetimit.

(Diskutime në sallë)

E dyta, diskutimi ka qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Fino!

Lidhur me diskutimin: a duhet të ketë Policia e Shtetit në përbërjen e këtij seksioni oficerë të Policisë Gjyqësore, mendimi im personal është që jo. Pse? Sepse, në fund të fundit, Policia e Shtetit e ofron shërbimin e hetimit nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Janë pothuajse dymijë punonjës të Policisë së Shtetit, që kanë atributet e Policisë Gjyqësore, flas ata që janë me grada të larta dhe që ligji ua jep të drejtën e hetimit, kurse pjesa tjetër e punonjësve të Policisë së Shtetit janë agjentë të Policisë Gjyqësore, pra e gjithë pjesa tjetër e trupës policore kanë funksionet e agjentit të Policisë Gjyqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj Kodi ka ruajtur linjën se nga kush kryhen funksionet e Policisë Gjyqësore? Nga seksionet dhe shërbimet.

Personalisht jam i mendimit që Policia e Shtetit nuk ka pse të ketë oficerë në përbërjen e seksionit të Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë, pasi e ofron vetë këtë shërbim për llogari të prokurorisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje, ligji që kemi sot për diskutim e ka zgjidhur këtë çështje në dispozitat e mëvonshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me Byronë Kombëtare të Hetimit, për mua është qartësisht parashikimi që ka pika 3 e nenit 30, që merret ashtu siç është dhe futet te neni 4. Edhe BKH-ja ka në dispozicion hetuesit dhe punonjësit e BKH-së. Edhe ajo në një farë kuptimi e ka Shërbimin e Policisë Gjyqësore brenda, sepse ka ruajtur në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit një nukël pranë agjencive të lira, të cilave ligji u jep attribute hetimi, siç është Policia e Shtetit apo

organet e tjera. Pra, sipas këtij ligji është mbajtur pak a shumë e njëjta kornizë edhe për Policinë Gjyqësore me BKH-në, duke marrë në konsideratë specifikat që ka BKH-ja.

Policinë e Shtetit kemi pasur në diskutim. Zoti Hodaj ka qenë pjesë e grupit të punës. Unë kam thënë: nëse do të ruajmë këtë linjë në ligj, pse do të ketë në seksionet pranë prokurorisë oficerë me 2 firma (me propozim të ministrit të Brendshëm dhe me miratim të drejtuesit të prokurorisë)? Jo, Seksioni i Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë ofron shërbime hetimore për institucionet, që ligji nuk u ka vënë trupë hetimore në dispozicion. Policia e Shtetit është vetë.

Unë them që te neni 4 të trasfuzohet edhe në terminologjinë ligjore, Kodi i Procedurës Penale. Mos na ngatërroni me shpikje termash! Merreni kështu siç është dhe futeni te neni 4. Nuk ka pse të thoni: punonjësit e Policisë së Shtetit pranë prokurorisë, por të thuhet: shërbimet e Policisë së Shtetit, të cilat janë pjesë e strukturës hetimore. Kjo është çështje e teknikës legislative. Ekspertët dhe grupi i punës mund ta marrin në konsideratë, se nuk është ky thelbi.

Që të jem i qartë edhe për kolegët, se zoti Fino me të drejtë përfshihet në këtë diskutim dhe i gjykon praktikisht këto gjëra, edhe pse është ekonomist me profesion, edhe për opinionin publik, pse erdhëm ne te ky ligj? Ne erdhëm për të zgjidhur një situatë, për të eliminuar ping-pongun mes prokurorit dhe Policisë Gjyqësore në funksion të hetimit.

Çfarë ndodhte në praktikë? Prokurori e shkarkonte barrën e zvarritjeve në hetim te Policia Gjyqësore dhe kjo e fundit thoshte, se oficeri i seksionit të Policisë Gjyqësore përpos hetimit kishte edhe detyra të tjera, që ia ngarkonte ligji për Policinë e Shtetit në funksion të këtij ligji dhe kështu, bëhej një ping-pong, duke ikur afatet e hetimit në drejtim të paditur.

Çfarë ndodh tani? Në momentin që sipas këtij ligji, prokurori do të disponojë një dosje, do ta delegojë atë te një oficer i Policisë së Shtetit për hetim. Ai deri sa të mbarojë hetimi, nuk mund të transferohet nga një drejtori vendore në një drejtori tjetër, pa i dhënë një zgjidhje dosjes hetimore, që ka. Ligji ka përcaktuar edhe rastet se si mund të lëvizë, por pa dëmtuar hetimin e dosjes.

Çështja tjetër, është çështje organizimi. Policia e Shtetit në strukturën e vet hetimore e organizon si të dojë. Sot e ka me këtë mënyrë organizimi, nesër e disponon me një mënyrë tjetër. E rëndësishme është të rrijë në brenda linjës, që ka përcaktuar Kodi i Procedurës Penale.

Unë prandaj kërkoj, zoti Hyseni, që neni 4 të shihet në lidhje të ngushtë me nenin 30 dhe 31 të Kodit të Procedurës Penale. Nëse keni nevojë, e lëmë të hapur, por duhet ta shohim në këtë frymë.

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj - Unë jam shumë dakord me ju. Qëllimi për ta ndryshuar këtë projektligj lidhet pikërisht me atë që ju e theksuat, për të eliminuar, ndër të tjera, të ashtuquajturin ping-pong ndërmjet institucioneve.

Pyetja ime është: kjo zgjidhje që është dhënë, a e zgjidh këtë ping-pongun që thatë ju? Unë them se nuk e zgjidh. Pse? Nëse do ta merrnim nenin të shkëputur, jam plotësisht dakord me ju, që duhet marrë ajo që është në Kodin e Procedurës Penale dhe duhet hedhur këtu. Jam shumë dakord se nuk ka logjikë tjetër, por Kodi i Procedurës Penale në vetvete nuk parasheh mënyrën se si do të jetë e organizuar kjo gjë nga pikëpamja e funksionalitetit.

Aty thuhet, se pranë prokurorisë është një seksion të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Aty nuk thuhet, se këta janë oficerë të Policisë Gjyqësore në funksion të prokurorit, nga pikëpamja për të zgjidhur disa çështje që nuk i zgjidh dot Policia e Shtetit.

Ju këtu me të drejtë, me po të njëjtin arsyetim që bëtë për BKH-në, thatë se BKH-ja ka hetues dhe punonjës të policisë. Siç e kemi parasysh, punonjësit kanë funksione hetimore. Ata janë ndihmës, por janë edhe për çështje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk janë vetëm për çështje administrative, por janë edhe për çështje që kanë të bëjnë për shkak të cilësive të veçanta, që kanë ata, si ekspertët etj.

Pyetja ime është: Kush janë hetuesit në rastin e prokurorive të zakonshme? Këtu e kemi zgjidhur, duke thënë se janë hetuesit dhe punonjësit e policisë. Po këtu kush janë hetuesit? Ju thatë me të drejtë, se kanë funksione hetimi për disa vepra specifike. Askush nuk e pengon me mënyrën se si është formuluar ligji me komisionin, që ta ketë këtë funksion, por nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Penale nuk e pengon që të ketë një strukturë hetimi të ngjashme, siç është BKH-ja, me hetues, e atashuar pranë prokurorisë përkatëse. Quhet seksion në këtë rast. Të vihet siç e ka Kodi i Procedurës Penale, se nuk kemi pse të bëjmë shpikje.

Pse e ngrita këtu? Funksionaliteti nuk jep zgjidhje. Është e vërtetë që kjo është një dispozitë që do të merret, siç e ka Kodi i Procedurës Penale, por merakun im është që pastaj, kur vjen radha për ta qartësuar këtë gjë, nuk e ka këtë dhe ne sot, duam apo nuk duam, me këtë zgjidhje që japim në tërësinë e ligjit, do të kemi ping-pong ndërmjet dy institucioneve, sepse nuk e kemi zgjidhur. Prokurori mund të thotë kur të dojë që këtë do ta bëjë unë me oficerët e mi të Policisë Gjyqësore, ose këtë e ka Policia e Shtetit.

Ky është problemi që, sipas meje, përbën thembrën e Akilit në organizimin dhe funksionalitetin e të gjithë shërbimit të hetimit në Policinë e Shtetit. A krijojmë ne me këtë një funksion të hetimit policor në funksion të prokurorit dhe nën drejtimin e prokurorit, se si do ta zgjidhim çështjen kur do të hetojë rastet ose disa vepra specifike, siç thatë ju, që

mund të ketë një lloj konflikti me ekzekutivin, kjo është një çështje tjetër? Me këtë ne nuk zgjidhim cili është hetimi i Policisë së Shtetit. Të gjithë hetojmë, por hetuesin në konceptin dhe logjikën që kemi përdorur te BKH-ja, nuk e zgjidhim këtu. Për arsye të njohura atje kemi rënë dakord të krijojmë një trupë speciale të prokurorëve dhe një trupë speciale të policisë, por kjo nuk do të thotë që këtej mund të mbajmë disa struktura, të cilat mund të mbivendosen për shkak të një lloj ping-pongu që është përdorur deri më sot.

Pyetja ime ishte në parim, por nëse relatorët, ekspertët dhe misionet thonë që në këndvështrimin tonë kjo nuk meriton shqetësimin tim, padyshim edhe unë mbështes ata. E rëndësishme është që dikush të na japë në tavolinë këtë garanci.

Dëgjova ish-kolegun dhe mikun tim Luli që përmendi në fillim fare konceptin e prokurorit, drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorit të Përgjithshëm. Ka ikur ajo kohë. Mua më vjen keq që sot prokurorët po punojnë me ligj të ri, por me mendje të vjetër dhe që shkojnë akoma t'i marrin leje drejtuesit të prokurorisë për të mbyllur hetimin apo për t'u dakordësuar. Unë e kuptoj arsyen. Duan të kenë një lloj komoditeti në raport me çështjen, që të mos i nxjerrin probleme njëri-tjetrit, por ama fryma e ligjit nuk ka qenë kjo dhe koncepti i drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorit të Përgjithshëm nga pikëpamja procedurale ka rënë. Zot i çështjes sot është prokurori.

Fatkeqësisht, prokurorët punojnë me një ligj të ri, por akoma me mentalitet të vjetër. Unë e di që kjo është periudhë kalimtare dhe shumë shpejt kjo gjë do të ndryshojë dhe do ta ketë efektin e vet pozitiv, por, në funksion të analizave që kemi bërë, ne duhet të ndryshojmë diçka për mënyrën se si do të funksionojë hetimi.

Jam dakord me atë që tha zoti Manja për lëvizjet, por lëvizja nga çështja në çështje apo brenda radhëve të policisë ndodh, se ajo nuk është një strukturë e mirëfilltë hetimore që ai të bëjë karrierë në hetim. Ai është polic që lëviz sa nga një strukturë në strukturën tjetër policore. Policia e Shtetit duhet të ketë një strukturë të posaçme hetimore, që ai që hyn në hetim duhet të dalë në pension në hetim. Kjo nuk do të ketë ekuivok. Unë kam vendosur të bëhem pjesë e strukturave të hetimit për arsye të caktuara (ka edhe shpërblime të posaçme) dhe do të mbetem në këto struktura, sepse kështu profesionalizohem dhe specializohem, por nëse nuk jam i përshtatshëm, dal fare nga policia. A e zgjidh ligji merakun tim apo rrotullohet përsëri tek ajo që ishim? Nëse e zgjidh, ju kërkoj ndjesë për shqetësimin dhe mirëkuptim për kohën që ju mora!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Çdo diskutim është në funksion të përmirësimit të ligjit. Në fakt, kur të shkojmë në nenet e tjerë të ligjit, unë mendoj që shqetësimin që ka zoti Xhafaj, që është shqetësim i të

gjithëve, është përpjekur ta zgjidhë neni 24 dhe 25 i po këtij ligji. Ndoshta kur të vijmë në diskutimin e këtyre dy neneve mund ta shohim edhe në detaje se si është zgjidhur ky shqetësim.

Kam vetëm një përgjigje për pyetjen se kush janë oficerët e Policisë Gjyqësore sot në BKH. Në fakt, kur kemi bërë ligjin për BKH-në kemi pranuar termin hetues, për t'i dalluar ata nga trupa tjetër, nga oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, sepse, në thelb, ekuivalenti i hetuesit të BKH-së sot është oficeri i Policisë Gjyqësore të seksionit, ndërsa ekuivalenti i punonjësit të BKH-së është punonjësi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Pak a shumë, kjo ka qenë linja që kemi ruajtur.

Në ligjin për BKH-në kemi përdorur termin hetues, ndonëse është një term që, në fakt, nuk e ka Kodi i Procedurës Penale, por te përkufizimet e ka zgjidhur neni 30, sepse thotë: “Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit ka statusin e OPGJ-së”, pra e ka sjellë në terminologjinë e kodit.

Të paktën fryma e këtij ligji, që po diskutojmë sot (ekspertët duhet të na e thonë nën për nen) do të zgjidhë shqetësimin që ngriti zoti Xhafaj, sepse ky ka qenë shqetësimi në hetim: përplasja mes prokurorisë dhe... Policia e Shtetit është njëra nga agjencitë, që ofron shërbime hetimi, por në përgjegjësi të agjencive që ofrojnë shërbime hetimi.

Vazhdoj të këmbëngul për nenin 4.

Zoti Hyseni, zoti Peçi, mirë është që te neni 4 të jetë tërësisht fryma e Kodit të Procedurës Penale.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, kam bërë një pasqyrim kur e kaluam në parim, por duke qenë se ka kaluar kohë e gjatë, po e bëj edhe një herë për kolegët.

Ka pasur dy ide se si do të ndërtohej trupa e re e hetimit.

Një ide, që mund të dukej më e thjeshtë dhe më funksionale, ishte për një trupë të vetme hetimore. Kjo do të thotë që të shkriheshin të gjitha në një trupë, gjë e cila është e pamundur të realizohet në kushtet e legjislacionit tonë, pasi ne kemi kaluar ligje procedurale me shumicë të cilësuar, të cilat nuk i ndryshojmë dot pa një konsensus, të cilin nuk e kishim. Ishim para zgjidhjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kalojmë asnjë ligj procedural pa një konsensus të gjerë. Ishim para zgjidhjes, nëse do ta linim situatën të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, më lejo ta mbaroj, se është interesante.

...Do ta linim situatën në këto kushte, ku hetimi çalon (realisht, edhe sot çalon, sado që kemi bërë gjithë atë reformë), apo do të ndërhyjmë për të përmirësuar hetimin?

U kalua në idenë e dytë, që tashmë trupa policore të mos jetë e shpërndarë në disa shërbime brenda Policisë së Shtetit.

Duhet të dini gjendjen. Kemi Polici Kriminale, Polici të Krimit të Organizuar, pra kemi disa struktura brenda policisë, që, le të themi, në mënyrë të pavarur kanë tagrin e oficerit të policisë gjyqësore dhe kryejnë hetime të ndryshme. Ne, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, arritëm konsensusin që të kemi një trupë policore, që është struktura hetimore. Pra, ideja do të shkojë në një trupë policore, që gjithë shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit të jenë brenda një strukture.

Etapa e dytë, ku besoj se gjen zgjidhje shqetësimi i kolegut Fino dhe i kolegut Xhafaj, është të specifikojmë mënyrën e urdhërimit, emërimit, transferimit dhe komandimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore me norma strikte. Ne kemi bërë norma strikte, për të mos ia lënë spontanitetit dhe dëshirës së shefit të radhës së komisariatit apo drejtorit...

Ju lutem, të mos japim informacione në këtë fazë, kur janë disa nene më pas, që i shpjegojnë këto shqetësime! Kryetari përmendi nenin 24 e në vijim, por ka edhe nene të tjera, që e zgjidhin këtë çështje.

Së treti, e kemi zgjidhur këtë shqetësim me krijimin e një strukturë të re. Kemi ngritur Komisionin e Policisë Gjyqësore, një komision unik, zoti Xhafaj. Komisioni i Policisë Gjyqësore është mekanizmi i tretë që kemi zgjidhur ne, që përfshin edhe seksionet që kalojnë nga ky komision, edhe shërbimet e policisë. Të gjithë ata persona, që kanë statusin e Policisë Gjyqësore (përveç BKH-së, që e ka të zgjidhur me ligjin e vet) kalojnë në këtë strukturë unike.

Këta tre mekanizma dhe fryma e re e ligjeve procedurale besojmë se do të sjellë një hetim shumë më të mirë. Koha do të tregojë nëse kemi të drejtë. Perfekt mund të mos jetë as ky, as çdo ligj që do të dalë, por mendoj se situata do të jetë shumë më e mirë dhe nuk do të jenë më këto shqetësime madhore, ndaj ju ftoj më të ecim përpara.

Për sa i përket situatës suaj, zoti kryetar, filozofia që kemi ndjekur është kjo: të mos qëndrojmë strikt në disa aspekte, duke i lënë mundësi ndryshueshmërisë së legjislacionit në të ardhmen. Përdorëm termin “punonjësit” me presje, duke thënë “të cilët kanë statusin”, në të dyja rastet, për t’ia lënë më të lirë situatën ndryshimeve për mirë të ligjeve në të ardhmen. Ne mund të përdorim fare mirë termin “shërbimet e Policisë së Shtetit, që janë pjesë e strukturës”, apo “hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit”. E kemi ...

Ulsi Manja – Transfuzioni direkt i nenit 31, ku thuhet: “Funksionet e Policisë Gjyqësore:” bëhen pjesë e nenit 4 dhe mbyllet debati.

Alket Hyseni – Në germën “b”, në vend të termit “punonjës” bëhet “shërbimet” dhe në germën “c” në vend të termit “punonjësit” bëhet “hetuesit”.

Ulsi Manja – Unë jam për të mos krijuar keqkuptime.

Neni 31 bëhet neni 4 “Për Policinë Gjyqësore”. Me këtë do të mbyllet çdo diskutim.

Faza ku jemi është diskutimi i të gjithë projektligjit, kur, në fakt, ne jemi vetëm te neni 4. Më duket se ligji, në nenet që vijnë, e ka zgjidhur tërësisht këtë shqetësim që kemi të gjithë.

Keni gjë tjetër?

Hedhim në votim nenin 4 me këtë sugjerim. Kush është dakord me nenin 4, që të përshtatet me nenin 31 të Kodit të Procedurës Penale? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Hyseni, do të kalojmë te kreu i dytë dhe të vazhdojmë, apo mund ta ndërpresim diskutimin te kreu i dytë dhe të vazhdojmë në mbledhjet që vijnë?

Alket Hyseni – Zoti kryetar, mendoj t’u lëmë kohë kolegëve, por edhe grupeve të tjera, që të njihen pak më tepër me draftin, në mënyrë që edhe propozimet të jenë më të frytshme, por edhe diskutimet për gjëra që janë zgjidhur në vijim, të mos bëhen. E mbylлим këtu për sot dhe do të diskutojmë në mbledhjen e radhës.

Ulsi Manja – Para se të ndërpresim mbledhjen për sot, për ta vazhduar, sepse e thashë që në fillim, që nuk do ta mbylлим sot nen për nen, do të ftoj edhe një herë relatorët, këshilltarët, por edhe përfaqësuesit që kemi sot në diskutim, të ulen paraprakisht dhe nëse keni sugjerime, që mund të bëhen pjesë e ligjit në këtë fazë, t’i konsultoni me relatorët. Të mos bëjmë diskutime në komision për çështje teknike, sepse duhet t’u japim kohë kolegëve deputetë, siç e tha, me të drejtë, zoti Fino, që nëpërmjet pyetjeve për nen të caktuara, të qartësohen jo vetëm ata, por edhe opinioni publik dhe oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të gjithë pjesëtarët e shërbimeve gjyqësore, që sot po e ndjekin diskutimin e këtij projektligji ndoshta me shumë interes nga televizioni.

Në adresën e Komisionit të Ligjeve kanë ardhur me qindra e qindra komente dhe sugjerime për këtë ligj nga oficerët e Policisë Gjyqësore, por jo vetëm.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë mbledhje të komisionit dhe për përfshirjen në diskutimet aktive!

Vazhdimi i këtij projektligji do të jetë në mbledhjet e radhës.

Nëse do të kërkojë kohë relatori dhe personat e pranishëm në komisionin e sotëm, që diskutimi të vazhdojë në një fazë tjetër, unë do ta lë ditën e hënë vazhdimin e diskutimit, por nëse do të kërkohet më tepër kohë për ta vazhduar, ju lutem, relatorëve, të bëjnë sugjerimin përkatës për ditën dhe orën e mbledhjes.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

